

26. Paqeruajtësit e OKB-së të cilët janë thirrur për të mbrojtur më shumë se 60 milionë refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit në mbarë botën. Lutuni që ata nuk do të abuzojnë me gratë dhe vajzat e reja, por do t'i trajtojnë ato me integritet dhe dinjitet.

27. Gratë dhe vajzat në rrezik për t'u përdorur si prostituta apo ato që shiten si "nuse" për të fituar para për anëtarët e familjes, të cilët janë duke pritur për leje për të punuar dhe për të përmirësuar jetën e tyre.

28. Refugjatët dhe personat e shpërngulur brenda vendit që përjetojnë tmerre ndërsa përpiqen të gjejnë vende të sigurta për të jetuar me familjet e tyre. Ndërsa disa janë mjaftueshëm me fat të gjejnë kampet e refugjatëve që ofrojnë sigurimin për nevojat e tyre themelore, disa mund të punojnë dhe të jetojnë në mënyrë të pavarur. Shumë prej tyre të përballen me situata të pashpresa dhe dëshpëruese.

29. Emigrantët të cilët lëvizin në një vend tjetër, jo për shkak të persekutimit apo luftës, por për arsye ekonomike dhe për këtë arsye nuk u kanë dhënë azil. Shumë prej tyre janë gati të vdesin se sa të dërgohen në shtëpi, ku nuk ka punë dhe familjet e tyre janë duke vuajtur.

30. Mijëra vajza të reja që arratisen nga dhuna e përdhunimeve të përsëritura në Laos dhe në Mianmar dhe pastaj mbërthehen në skllavërinë e seksit në Tajlandë. Lutuni që ato do të gjejnë një shtëpi të sigurt në strehat ku ato mund të marrin trajnim për punë dhe fjalë shprese ndërsa dëgjojnë në gjuhën Burmese, S'gau Karen, Isaan dhe Thai programet "Shpresë për ty".

31. Të lutemi për çdo refugjat, individ të çmuar, të dashur nga Perëndia, i cili është përdhosur nga familja, kultura, gjuha dhe çdo gjë familjare. Lutuni që këta njerëz të rënduar të gjejnë shpresë përmes veprave të mirësisë që të krishterët u ofrojnë atyre në emër të Jezusit. "Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë, isha i huaj dhe më pritët" (Mat. 25:35).



Shumë herë, Perëndia u përgjigjet lutjeve tona në mënyra që as nuk i mendojmë. Për vite të tëra, mijëra ndërmjetësues të "Shpresë për ty" janë lutur që gratë e izoluar në botën Arabe, Azinë Qendrore dhe Afrikën e Veriut do të kenë mundësi të dëgjojnë për dashurinë e Perëndisë për to. Tani, miliona prej këtyre grave kanë lënë izolimin, atë me të cilin janë përballur në vendet e tyre dhe janë në kërkim për siguri dhe shpresë në Evropë. Kjo është një mundësi për shumë që më në fund të dëgjojnë për Perëndinë, që i do dhe i fton ato të marrin dhuratën e tij të shpëtimit me anë të Jezus Krishtit, Birit të tij.

Ndërsa kriza Evropiane e migrimit të disa viteve më parë është moderuar, në mbarë botën ka miliona refugjatë dhe persona të shpërngulur brenda vendit të cilët janë të detyruar ta bëjnë këtë për shkak të luftës, persekutimit, urisë apo fatkeqësive natyrore. Ndërsa udhëtojnë për t'i shpëtuar kushteve të mjerueshme - dhe ndonjëherë edhe pas mbërritjes në kampet e refugjatëve - ata janë të pambrojtur ndaj sëmundjeve, përdhunimit, skllavërisë, urisë dhe vdekjes. Ata janë të frikësuar dhe të traumatizuar, dhe kanë nevojë për miq të krishterë të cilët mund t'u ofrojnë atyre shpresë.

Këta miliona refugjatë vuajnë jo vetëm fizikisht, por edhe psikologjikisht. Kjo traumë ka për t'i ndjekur ata për vite të tëra. Shumica e tyre kanë lënë pas prindërit e tyre pleq, kanë parë të dashurit e tyre të vdesin nga një vdekje të tmerrshme, ose janë rrahur dhe dhunuar brutalisht. Tani atyre u duhet të mësojnë gjuhë, ligje dhe zakone të reja. Shumica nuk janë të mirëpritur në vendet e tyre të reja. Prania e tyre do të shkaktojë ndryshime të rëndësishme kulturore në komunitetet e tyre të reja dhe si pasojë shumë nga fqinjët e tyre do t'i kenë frikë ose do t'i urrejnë.

TWR dëshiron t'u japë shpresë refugjatëve, të cilët kanë lënë çdo gjë me shpresën e një jete më të mirë. Duke bashkëpunuar me kishat dhe shërbesat e refugjatëve dhe duke u dhënë atyre pajisjet mediatikeqë përmbajnë tema të cilat adresojnë çështje jetësore me të cilat përballen këta azilkërkues, ne mund të ndajmë lajmin e mirë të Jezu Krishtit në gjuhën e tyre dhe në një mënyrë që është e përshtatshme nga pikëpamja kulturore dhe mjaft aktuale.

"Kur një i huaj banon bashkë me ju në vendin tuaj, mos e trajtoni keq" Levitiku 19:33

## Të lutemi për refugjatët



Programi "Shpresë për ty" transmetohet në 73 gjuhë  
Kërkesat mujore të lutjes përdoren në 100 gjuhë  
Dëgjoni kalendarin e lutjes online në:

[twr-albania.com](http://twr-albania.com)

Dëgjoni programin "Shpresë për ty" në:  
Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30  
Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00  
Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

## Të lutemi për ...

1. Nën timer refugjate që përpiqen për të kujdesen për familjet e tyre me furnizime të kufizuara të ushqimit, ujit të pastër, energjisë elektrike dhe higjenes.

2. Programet e Shpresë për Ty në gjuhët respektive të grave refugjate për të arritur ato gra që duan të mësojnë për Jezusin.

3. Shumë refugjatë që e kanë pranuar Krishtin kur kanë dëgjuar për herë të parë për dashurinë e Perëndisë dhe dhuratën e tij të shpëtimit. Liria për të zgjedhur besimet e tyre është e re për shumë prej tyre, prandaj lutuni që ata do të bëjnë zgjedhje të mençura.

4. Refugjatët në kampin e refugjatëve Dadaab në Kenia, një nga më të mëdhenjtë në botë, të cilat përballen me një të ardhme të panjohur ndërkohë që planifikojnë të mbyllin procedurat për të cilat kanë ngritur zërin disa herë.

5. Mijëra refugjatë që shkojnë në kisha dhe madje kanë kërkuar të pagëzohen. Edhe pse disa mund ta bëjnë këtë me shpresë se kjo do të përmirësojë shanset e tyre për azil, lutuni që shumë prej tyre me të vërtetë do të bëhen dishepuj të Krishtit.

6. Sigurimin e familjeve kujdestare të gatshme dhe shtëpi të sigurta për gati 760 fëmijë refugjatë të pashoqëruar të cilët banojnë në Adis Abeba. Lutuni që Zoti t'i shërojë nga trauma psikologjike që ka ardhur si pasojë e ekspozimit ndaj dhunës gjatë fëmijërisë.

7. Njerëzit, të cilët tashmë përpiqen shumë për të siguruar për familjet e tyre dhe më pas janë dëshmitarë që vendet e tyre pushtohen nga mijëra refugjatë në nevojë.

8. Mijëra Eritreas në kampe të ndryshme refugjatësh nëpër Etiopi që kërkojnë strehim nga uria, skllavëria, tortura dhe vrasjet në vendin e tyre.

9. Gratë e krishtera në Evropë që po ndimojnë refugjatët që kërkojnë azil. Lutuni që këta refugjatë nga Lindja e Mesme, Afrika, Azia Qendrore dhe Evropa do të gjejnë një vend të sigurt, miqësi dhe dhuratën e shpëtimit të Perëndisë.

10. Më shumë se 800.000 refugjatë somalezë kryesisht në Kenia, Etiopia dhe Jemen të dëgjojnë programin "Shpresë për ty" në gjuhën somaleze dhe të mësojnë se Jezui Krishti i do dhe dëshiron t'u japë atyre dinjitetin dhe lirinë nga skllavëria e praktikave të tyre poshtëruese kulturore.

11. Të lutemi për ata 140,000 refugjatë nga Mianmar, kryesisht Karen, të cilët jetojnë në kampe refugjatësh në Tajlandë, disa prej 30 vitesh. Rreth 70 për qind e popullsisë Karen janë budistë apo animistë dhe rreth 25 për qind janë të krishterë. Lutuni që programi "Shpresë për ty" në gjuhën Karen do të sjellë rehati dhe paqe në jetën e tyre të trazuar. Këta refugjatë etnikë u larguan nga vendi i tyre për t'i shpëtuar vrasjeve, torturave, përdhunimeve, minave në tokë dhe punës së detyruar.

12. Të mbijetuarit e masakrave, spastrimit etnik, luftërave dhe trazirave civile, betejave fraksionare, konflikteve fetare dhe politike dhe luftërave për pavarësi. Kërkojini Zotit t'i bashkojë ata dhe t'u sigurojë shërim dhe paqe për fëmijët e tyre.

13. Gratë që ngelin shtatzënë pasi janë përdhunuar gjatë luftës ose përgjatë udhëtimeve të vështira si refugjate. Kërkojini Zotit që t'i ndihmojë ato të gjejnë ndihmën mjekësore, psikologjike dhe shpirtërore për të cilën kanë nevojë.

14. Banorët vendas, që ndihen të kërcënuar, kur shohin qindra apo edhe mijëra refugjatë - duke sjellë me vete kultura, fe dhe gjuhë të huaja - që lëvizin në komunitetet e tyre.

15. Refugjatët, jetët e të cilëve janë në rrezik, nëse të tjerët zbulojnë se ata janë duke dëgjuar programet radiofonike të krishtera dhe duke studiuar Shkrimet.

16. Të krishterët të cilët kanë lënë komunitetet e tyre apo vendet për shkak të persekutimit fetar. Lutuni që ata do të gjejnë grupe besimtarësh që do t'i duan dhe mirëpresin ata.

17. Gratë dhe vajzat që janë rrahur shumë keq, janë përdhunuar brutalisht dhe vazhdimisht dhe detyrohen të martohen me militantët fetarë nga frika për jetën e tyre, ose për të shpëtuar jetën e të afërmeve të tyre. Shumë prej tyre kryejnë vetëvrasje për t'i shpëtuar tmerreve të skllavërisë seksuale.

18. Familjet që janë ndarë dhe nuk e dinë nëse disa anëtarë janë ende gjallë. Edhe pas gjetjes së të dashurve të tyre, në shumë raste, ata nuk mund të bashkohen, sepse humbasin ndihmën e tyre financiare dhe nuk do të jenë në gjendje të mbijetojnë së bashku pa atë.

19. Partnerët kombëtarë dhe organizata të krishtera që drejtpërsëdrejti ndërveprojnë me refugjatët ndërsa shpërndajnë programet e TWR-së dhe i ndihmojnë ata që duan të kuptojnë të vërtetat e Perëndisë.

20. Udhëheqësit dhe për popujt e Gjermanisë, Francës, Greqisë, Spanjës, Italisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, vendet kryesore që kanë numrin më të madh të aplikimeve për azil.

21. Favor të dhënë nga udhëheqësit e vendeve që presin mbi 3 milion emigrantë nga Venezuela, refugjatë dhe azilkërkues ndërsa ata kërkojnë format alternative të statusit ligjor. Kjo do t'u mundësojë atyre që të mbeten aty ku janë ligjërisht dhe të kenë të drejtat dhe shërbimet themelore.

22. Qeveritë në mbarë botën për të krijuar reforma ligjore dhe politika të nevojshme që të adresojnë në mënyrë efektive çështjen e shtetësisë dhe për t'i japin fund joshetësisë. Kjo praktikë i përshkruan njerëzit si pa kombësi. Rreth një e treta e këtyre njerëzve janë fëmijë.

23. Ndryshimin e zemrave të udhëheqësve nga Perëndia në lidhje me një dyzinë vendesh që nuk i lejojnë gratë të kalojnë shtetësinë për fëmijët e tyre, duke rezultuar pa shtetësi, në të njëjten kohë kur etërit e tyre janë të panjohur, të zhdukur ose të vdekur.

24. Udhëheqësit ndërkombëtarë që t'u kërkojnë qeverive abuzive të mbajnë përgjegjësi për sulmet e tyre mbi të pafajshmit, si dhe keqpërdorimin e burimeve të tyre, të vlefshme natyrore (naftë, diamante, etj) dhe financat e marra nga organizatat humanitare. "Perëndia im, më çliro nga dora e të pabesit, nga dora e të çoroditurit dhe të atij që përdor dhunën." (Ps 71: 4.).

25. Frymën e Perëndisë të lëvizë në të gjithë vendet e shkatërruara nga lufta, duke shëruar zemrat, mendjet, dhe duke ripërtërirë familjet.